



Qendra e Ndhmës Ligjore Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Durrës

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare po zbaton projektin, “Fuqizimi i grupeve të varfra dhe të margjinalizuara përmes ofrimit të ndihmës juridike falas dhe edukimit ligjor, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”, me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD dhe fonde të Qeverisë së Turqisë.

Projekti ka si objektiv kryesor rritjen e aksesit të individëve dhe grupeve të varfëra/në nevojë në sistemin e drejtësisë. Objektiva të veçanta të projektit janë: Rritja e ndërgjegjësimit mbi të drejtat ligjore dhe si të përdoren këto të drejta, fuqizimi i individëve dhe grupeve të varfëra/në nevojë për të kërkuar të drejtat e tyre përmes rritjes së aksesit në ndihmën ligjore, forcimi i aftësive praktike të anëtarëve të skuadrës *pro bono* përmes përfshirjes së tyre në aktivitetet e projektit, rritja e bashkëpunimit të Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare me institucionet në nivel vendor si Dhoma e Avokatisë Durrës, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Durrësit, organizatat jofitimprurëse, zyra lokale e Avokatit të Popullit, etj.

Disa nga aktivitetet kryesore të projektit janë: Ofrimi i ndihmes ligjore falas për individë nga komunitetet e varfëra/në nevojë, takimet me institucionet në Durrës, trajnimi i skuadrës *pro bono* me studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti Durrës, organizimi i tre aktiviteteve ndërgjegjësuese me komunitetin, organizimi i aktiviteteve të informimit ligjor në rrugë, organizimi i një aktiviteti të përbashkët me qendrat që ofrojnë ndihmë ligjore në Durrës dhe në nivel kombëtar, me qëllim ndarjen e eksperiencave, dhënien e informacionit mbi projektin, etj.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, një Qendër e Ndhmës Ligjore Falas funksionon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Durrës. Dy avokate të QNLQ-së, të specializuara në fushën e të drejtave të njeriut, ofrojnë këshillime e përfaqësime ligjore Falas.

Individë dhe grupe të varfëra dhe në nevojë mund të përfitojnë, pranë Qendrës së Ndhmës Ligjore Falas në Durrës, shërbimet si më poshtë:

- Informim mbi të drejtat dhe mjetet ligjore;
- Konsultim mbi çështjen tuaj ligjore;
- Përgatitje e kërkesave, ankesave dhe dokumenteve të tjera ligjore;
- Këshillim në lidhje me procesin;
- Këshillim për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjeve;
- Mbështetje dhe referim për ndërmjetësim;
- Përfaqësim ligjor në çështjet gjyqësore civile;
- Përfaqësim ligjor në çështjet gjyqësore administrative;

- Përfaqësim në institucionet shtetërore administrative;**
- Mbështetje dhe përfaqësim për viktime të krimeve në çështjet penale;**

Qendra ndodhet në mjediset e brendshme të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Kati i Parë.

Ju mirëpresim!